



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 22.01.2021, merr këtë:

VENDIM

për akreditim të grupit të vëzhguesve të Demokracia për Zhvillim (D4D)

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, për akreditimin e grupit të Vëzhguesve të OJQ vendore "Demokracia për Zhvillim" me dhjetë (10) vëzhgues, për vëzhgimin e aktiviteteve zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 shkurt 2021.
- II. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë OJQ vendore "Demokracia për Zhvillim" me obligimet e organizatave të akredituara dhe vëzhguesve të tyre që rrjedhin nga neni 4 i Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftoj OJQ vendore "Demokracia për Zhvillim" për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.